



T R A N S K R I P T

I mbledhjes inauguruese të Kuvendit komunal, e mbajtur më 20.12.2017, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhjen e hapi përfaqësuesi i ekzekutivit të Komunës, z. Osman Bllaca.

Osman Bllaca:

Të nderuar anëtarë të pranishëm urime për mandatin që e keni fituar nga qytetari. I nderuari kryetar Shpend Ahmeti urime për zgjedhjen edhe për katër vite kryetar i Komunës.

Të nderuar mysafir të pranishëm në bazë të legjislacionit të qeverisjes lokale dhe rregullave të cilat janë të parashkruar për mbajtjen e mbledhjes inauguruese ku do të ketë vetëm dy pika të rendit të ditës, parashihet që anëtari më i vjetër i zgjedhur nga 51 apo sa ka asambleja e Komunës së Prishtinës të drejtoj seancën inauguruese.

Në koordinim me Komision komunal zgjedhor dhe sekretarinë e Kuvendit për organizimin e kësaj mbledhjeje dhe gjendjen civile në Komunë që është anëtari më i vjetër është z. Shefki Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës, i lindur më 2.05. 1950, sipas gjendjes civile dhe zyrtare është personi më i vjetër.

Atëher ftoj z. Shefki Gashi që të vjen dhe të filloj me mbledhjen inauguruese të ditës së sotme.

Shefki Gashi:

Përshëndetje për të gjithë, urime dhe suksese asamblistëve të ri dhe të vjetër, urime për kryetarin, për qeverinë.

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit pa dallim se nuk kam informatë për subjektet na të cilat vijnë por po e shoh se qenka numri i konsoliduar.

Por një përshëndetje të veçantë për mediat e shkruara dhe elektronike.

Prandaj besoj se ne do të vazhdojmë me procedurën, sot në rend të ditës paskemi dhënien e betimit të anëtarëve të asamblesë komunale si dhe betimin e kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Prandaj vazhdojmë me procedurën ju lutem me e lexuar deklaratën e betimit, sipas rregullës qenka me u ngritur në këmbë të gjithë ju e thoni emrin e juaj.

Unë Shefki Gashi betohem se do ti kryej me nderë, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje e sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtarë i Kuvendit Komunal të Prishtinës në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë qytetarët.

Betohem.

Urime.

Ju faleminderit.

Tani ftoj kryetarin z. Shpend Ahmeti që të bëjë betimin para anëtarëve të Kuvendit.

Shpend Ahmeti – kryetar:

Faleminderit z. Gashi, urime të gjithëve për zgjedhjen në mandatin e ri.

Unë, Shpend Ahmeti betohem që do ti kryej detyrat dhe do ti ushtroj kompetencat si kryetar i Komunës së Prishtinës me nderë, besnikëri në mënyrë të pa anshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që ti siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë.

Faleminderit z. Gashi, nuk dua ta zgjas e para që dua ta them të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal disa për mandat veç vazhdim të mandatit, e disa për herë të parë së pari më lejoni që të ju uroj në përzgjedhjen për të ushtruar detyrën e këshilltarit komunal në Komunën e Prishtinës.

Ju them dhe ashtu siç u betova se do ta kryej detyrën time me nder dhe besnikëri po ashtu betohem para juve se do ta kryej detyrën në frymë të bashkëpunimit me secilin prej juve.

Dua të ju them edhe sot këtu edhe publikisht çofshin pozitë apo opozitë besoj e se me secilin do të mundemi të ndërtojmë një relacion të bashkëpunimit, të komunikimit të sinqertë dhe natyrisht të kritikave të cilat i pres nga secili prej juve.

Prandaj edhe ju që jeni këshilltar të Lëvizjes Vetëvendosje e në koalicion me LVV-në për qeverisje, edhe anëtarët e tjerë të opozitës pres që çdo propozim tonin ta shikoni me sy kritik gjithmonë duke menduar për të mirën e qytetarëve.

Po ashtu më lejoni se dera e kryetarit të Komunës do të jetë e hapur për secilin asamblist, edhe njëherë pa marr parasysh se cilit subjekt politik i takojnë në mënyrë që të diskutojmë për të gjitha çështjet ju dëshironi ti ngritni e për të cilat keni marr edhe besimin e qytetarëve dhe po ashtu i keni nga konstituencat apo nga votuesit e juaj.

Pa dyshim se në këtë mandat në katër vitet e ardhshme na presin punë të mëdha e ato që i takojnë më së shumti Kuvendit Komunal dhe mendoj se janë puna më e vështirë që do të bëjmë së bashku ka të bëjë me hartën zonale i cili është Plani rregullativ i qytetit të Prishtinës, që duhet edhe sipas ligjit edhe pas kalimit të Udhëzimit administrativ që në vitin 2018 ta kemi si prioritet.

Po ashtu kemi edhe shumë sfida të tjera siç janë implementimi i Planit të mobilitetit, përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe shumë e shumë gjëra tjera të cilat kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së secilit qytetarë në Komunën e Prishtinës.

Andaj që nga sot e tutje e katër vitet e ardhshme uroj që të punojmë për të mirën e qytetarit, në frymë të bashkëpunimit por asnjëherë duke mos e anashkuar apo larguar kritikën e cila është e domosdoshme për të ecur në mënyrë të drejtë përpara.

Andaj edhe njëherë faleminderit të gjithë qytetarëve të Prishtinës i ftoj edhe mediat, edhe shoqërinë civile si dhe të gjithë të interesuarit të na ndjekin, të na monitorojnë ashtu siç kanë bërë edhe katër vitet e kaluara. I falënderoj qytetarët që votuan në këtë zgjedhje çofshin për neve, çofshin për kundër kandidatët, i falënderoj të gjithë për një proces të mirëfilltë zgjedhor. Urime të gjithëve edhe njëherë dhe na prift e mbara në punën së bashku.

Shefki Gashi:

Faleminderit kryetar.

Nuk kemi diçka tjetër.

Me këtë përmbillet seanca, kurse seanca tjetër kur do të zgjidhen organet apo trupat e Kuvendit do të caktohet te shohim se kur të mëremi vesh, prandaj seanca e sotme përfundoi. Ju faleminderit, mirupafshim në seancën tjetër.

Osman Bllaca:

Ju lutem të gjithë anëtarëve të nënshkruajnë deklaratën solemne e nënshkruani dhe e leni në vend, si dhe ju lutem që të gjithë së bashku të dalim jashtë dhe të bëjmë një fotografi.